

89

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, me gjyqtarin gjykues Fatmir Krasniqi, me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. R. nga Prizren, me mbrojtesin e tij av.V. O., për shkak se ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, sipas propozim akuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Prizren PP.nr.2383/10, të datës 28.01.2011, pas mbajtjes së seancës shqyrtimit kryesore në prezencën e Prokurorit Themelor në Prizren B. S., të akuzuarit, me datë **15.07.2016** muar dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S. R., nga i ati Gall dhe eëma Sanje - e vajzerise Mu., i lindur më datë 1.1.1977 në Adan-Prizren, ku edhe jeton në rr. L. G. S. 71, i martuar baba i 2 fëmijve, i pa pune, me shkolle fillore të kryer, i gjendjes së dobet ekonomike, me nacionalitet shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me date 31.07.2010 rreth ores 03,55 min, në lagjen Arbana, rr. L. G. S. Qemali, ne Prizren, ne gjendje te dehur pengon personat zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare, duke i fyter dhe kanosur me perdonim te ateqasshem te dhunes, i cilë rezulton me lendime te lehta trupore, ne ate menyre qe pasi i pandehuri kishte shkaktuar aksident trafiku, gjate nderrmarjes se veprimeve zyrtare te policeve te trafikut, ju drejtohet me fjalet "kam me ta q...nenen" e kap per jeleku dhe e godet me shqelma ne gjoks policin Bajraktari Avdij si dhe e fyen me fjalet "çka ki ti me mua une ti q... robet etj", i cili vazhdon edhe me tej me kanosje dhe tentime per te sulmuar, me qe ishte shume agresiv, policet tentojne ta prangosin, por gjate rrezistimit te tij, policet Bajraktari Avdij si dhe Nuredin Xhaçaj, marrin lendime te lehta trupore te konstatuara ne mendimin e ekspertit mjeko-ligjor te dates 14.12.2012.

Me këtë ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 par.2 lidhur me par.1 të KPK



90

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 7, 41,42, 43 par.1 pika 1.2, 45, 73,74, 75,76 e
neni 316 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se, dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Per vepren penale nen 1 te dispozitivit, ne kohezgjatje prej **3 muajve**, dhe

Obligohet i akuzuari që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale (sipas llogarisë së gjykatës), sado qe te jene ato, në emër të shpenzimeve te dy ekspertizave mjeko-ligjore shumen prej **40.00 eurove**, si dhe ne emer te paushallit gjyqësor, shumen prej **50 eurove**, të gjitha keto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi, nen kërcënim të ekzekutimit te dhunshem.

Te demtuarit B... A... nga Prizreni, m... q... Lam 7/6 nr.10, dhe N... Xh... J... nga Prizreni m... Vj... nr.10, per realizimin e kerkeses pasurore-juridike udhezohen ne kontest te tregullt civilo-juridik.

Arsyimet

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar propozim akuzën PP.nr.2383/10 të datës 28.01.2011 kunder te akuzuarit S... R... nga A... Prizren, për shkak te veprës penale pengimi i personit zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së,

Gjyqtari gjyques pas qe beri shikimin ne shkresat e lendet, ku aktgjykimi ka qene i ankimuar, duke vepruar sipas veretjeve te gjykates se Apelit ne Prishtine, mbi shkeljet esenciale te dispozitave ligjore, te cilat shkelje i ka eliminuar, dhe ka vertetuar kete gjendje faktike.

Prokurori i shtetit ne Prizren,Besim Susuri ne fjalen e tij perfundimtare deklaron: mbetem ne teresi prane te thenave si ne pakuza,sa i perket dispozitivit nen 1 perkitazi me vepren penale pengimi i personave zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se, theksoj se gjate administrimit te provave sidomos nga degjimi i deshmitarit B... i Berishë..., i cili diten kritike ka qene sypames dhe pjesemarres ne vendin e ngjarjes ne cilesi te personit zyrtar, vertetohet se i pandehuri ka kryer vepren penale te permendor me larte, mirpo konstatimi im eshte se i njejti kete veper penale me teper e ka kryer nga provokimi i thelle verbal i bere nga pjestari i policise B... Avd... i cili perveq tjerash te pandehurin e ka quajtur kelysh dhe shume fjale te tjera te renda e ofenduese te cilat kane denigruar personalitetin e te pandehurit. I provokuar thelle nga sjellja jokorrekte e zyrtarit policor Bajram Avdijai konsideroj se ka qene normale nje reagim i tille i te pandehurit per nje situate te tille te konsiderohet normale-perkitazi me reagimin kunderreagimin ndaj zyrtarit policor.Ky provokim nga ana e zyrtarit policor B... A... vertetohet gjithashtu nga deshmia e deshmitarit te permendor i cili verteton se ka ndegjuar te thenen e permendor drejtuar te pandehurit, nderkaq sjellja korrekte paraprake e te pendehurit me zyrtarit policor Bajram Berishën dhe Mehmet morinen te cilet prarprakisht kane qene ne vendin e ngjarjes, ka qene jashtzakonisht nderkaq vetem pas ardhjes se policeve te trafikut regional ne Prizren i njejti i provikuar nga policet ka qene i detyruar te reagoje ne ate menyre.Andaj kerkoi nga gjykata qe me rastin e caktimit te llojit dhe lartesise se denimit ndaj te pandehurit S...

Regjaj, tim kete parasysh te gjitha keto rrrethana e sidomos faktin se i njejt i ne nje situate te tille ka qene i provokuar thelle. Andaj i prpozoi gjykates qe i njejt i perkitazi me kete veper penale te shpallet fajtor dhe te denohet sipas ligjit.

91

Mbrojtesi i te akuzuarit av.Vl. O. ne fjalen e tij perfundimtare deklaron: paraprakisht konsideroj mjaft profesionale qasjen e prokurorit te shtetit ndaj rrrethanave te dites kritike te dt. 31.07.2010, megjithate konsiderojme se me administrimin e provave ne kete qeshtje penale nuk eshte vertetuar pretendimi i prokurorise sipas aktakuzes se i pandehuri S. R. diten kritike ka kryer vepe en penale pengimi i personave zyrtar gjate kryerjes se detyres zyrtare, gjykates me rastin e vlesresimit te provave te kete parasysh dekleraten e deshmitareve Bajr. Berisha e Mehmet Morina qe kane qene neutral ne kete qeshtje penale, dhe tia fal besimin e plote, pasi qe te njejt i kane qene te paret ne vendin e ngjarjes pas aksidentit te komunikacionit dhe deshmise se tyre se sjelljet e te pandehurit ndaj zyrtareve policor kane qene shume korekte edhe perkunder faktit se i pandehuri ka pranuar qe naten kritike ka qene nen ndikimin e alkooholit. Se si erdhi deri te kryerja e vepres penale per te cilen edhe akuzohet i pandehuri, gjykata ne rastin konkret ka mjaft prova me te cilen vertetohet se sjelljet e personave zyrtar Bajr. Av. R. ne kuader te detyres zyrtare nuk kane qene sjellje profesionale e aq me pak zyrtare, nje qasje te tille joprofesionale e ofenduese denigruese per personalitetin e te pendehurit e konsiderojme se e zhvesh personin zyrtar nga petku i autorizimeve qe jep ligji, andaj me sjelljet e tillë nuk kemi autoritet zyrtar nga ana e policit tone. Poashtu me degjimin e deshmitareve Mehmet Morina e Bajr. Berisha te cilet edhe kane asistuar pas eskalimit te situates me arrestimin e te pendehurit te njejt me perjegjesi te plote kane deklalruar se i pandehuri S. R., nuk e ka sulmuar zyrtarin policor Bajr. A. ashtu si pretendon akuza, por reagimi i te pandehurit ka qene normale pas fyerjes dhe denigrimit te personalitetit te tij. Perfundimisht i propozoj gjykates qe pas vleresimit te te gjitha provave te akuzuarin S. R. ta liroj ngaakuza sa i perket dispozitivit nen 1 te kesaj pakuze, ne mungese te provave, ndersa per dispozitivin nen 2 te kesaj propozimakuze te merr aktvendim refuyues per shkak te parashkrimit te vepres penale per te cilen ngarrkohet i akuzuari. I pandehuri edhe njehere shpreh dhe e ndien keqardhje per demin material qe i ka shaktuar policeve se Kosoves ne rastin konkret te vetures zyrtare te policeve, si pasoje e veprimeve te te pandehurit pas gjithe asaj ngjarje qe ka ndodhur naten kritike.

I akuzuari S. R. ne fjalen e tij perfundimtare deklaron: se e perkrahi dhe qendroj ne teresi prane fjalet perfundimtare te mbrojtesit tim av. Vl. Ostrozzi, megjithate shtoj se ne nje forme jam i penduar dhe u kerkoi falje policeve per ate se qka ka ndodhur, i premtoj gjykates qe ne te ardhem nuk do te perserise keso lloj te vepres penale dhe do te jem me i kujdeshem.

Te demtaurit Bajr. Avdilaj e Nuredin Xhemajli ne fjalen e tyre perfundimtare te njejt i bashkangjiten ndjekjes penale ndaj te akuzuarit dhe parashtrojne realizimin e kerkeses pasurore-juridike.

Në shqyrtimin kryesorë i akuzuari ka deklaruar se nuk e ndien veten fajtorë për vepren penale për të cilat ngarkohet, sa i perket pengimit te personave zyrtar ne kryerjen e detyres zyrtare, duke shtuar se qe me pare ka qene i provokur me fajlet e renda ofenduese e banale si klysh.

Gjykata në shqyrtimin kryesorë i administroi të gjitha provat e nevojshme dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe në bazë të gjithave vërtetoi këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzari S. R. diten kritike me dt. 31.07.2010 rreth ores 03,55 min, ne lagjen Arbana ne T. Ismail Qemali ne Prizren ne gjendje te dehur pengon personat zyrtar ne kryerjen e detyres zyrtare, duke i fyer dhe kercnuar me perdonim te ateqasshem te dhunes, i cili rezulton me lendime te lehta trupore, ne ate

92

menyre qe pasi i pandehuri kishte shkaktuar aksident trafiku, gjate ndermarjes se veprimeve zyrtare te policeve te trafikut, ju drejtohet me fjalet "kam me ta q...nenen", e kap per jeleku dhe e godet me shqelma ne gjoks policin Bajram Avdijaj si dhe e fyen me fjalet "çka ki ti me mua ti q...robet", i cili vazhdon edhe me tej me kanosje dhe tentime per te sulmuar, me qe ishte agresiv, policet tentojne ta prangisin, por gjate rezistimit te tij, policet Bajram Avdijaj e Nuredin Xhemajli marrin lendime te lehta trupore te konstatuara ne mendimin e ekspertit mjeko-ligjor te dt.14.11.2010.

I akuzuari Sali Rrustica gjatë shqyrtimit kryesorë ka deklaruar se naten kritike vone pasi qe u ktheva së bashku me shoqen time me veture ngase isha ne nje aheng familjar, ne udhekryqin e lagjes Arbana perball shkolles fillore "Ibrahim Fehmiu" kam shkaktuar aksident trafiku, me nje veture tjeter, isha pak nen ndikim te alkooliti, ku ne vend te ngjarjes erdhen policet e Alpes dy polic, ne pyetjen se a keni nevoje per ndihme mjekesore, nje vajze nga vetura tjeter e kerkoj ndihmen dhe erdhi vetura e emergjences, se spitalit te Prizrenit, menjehere edhe pse une isha me policet shume kooperativ duke ju thene se nese kam gabuar dhe kam shkel ligjin mund edhe te me arrestoni, policet me thane se per rastin e aksidentit kompetencia edhte e policeve te trafikut, ku erdhen dy police te trafikut, mua mu ka drejtuar polici Bajram Avdijaj, ia kam dhene dokumentat e mia, ka shkuar te vetura tjeter ti kerkoj dokumentat, gjate bisedes me vozitesin e vetures tjeter dhe me pronarin e shtepise Qemal te cilit i eshte shkaktuar dem ne deren e shtepise nga ana e aksidentit, menjehere me eshte drejtuar polici Bajram Avdijaj me gisht duke me thene: "arrestojeni". Pasi qe mu afroa polici Bajram Avdijaj, me ka thene tash kam me te arrestuar more pijandur, qen i rrugeve, kelysh ta tregoj tash qefin, me ka kapur mbrapa per qafe qe te me arrestoj une kam rezistuar nuk kam pranuar prangosjen se nuk kam ditur rastin i kane ardhur ne ndihme edhe policet e tjer koleget dhe me kane prangosur dhunshem derisa me kane futur ne veture te policise, kurse une nuk e kam sulmuar askend fizikisht nga policet, perpos se isha i pakenaqur dhe kam sharre dhe ofenduar policin Bajram Avdijaj me nenen, dhe ke me pa se kush jam une. Sa i perket vepres penale gjoja pengim i personave zyrtar gjate kryerjes se detyres zyrtare une per kete veper nuk e ndiej vehten fajtor, kurse sa i perket vepres penale demtim i pasurise se luajteshme, per kete veper e ndiej vehten fajtor nga se edhe para gjykates e kam pranuar fajesin.

Gjykata këtë gjendje faktike e ka vërtetuar edhe nga provat materiale dhe atë nga rapporti i qendres emergjente te Spitalit Rajonal në Prizren me nr.16855 dhe nr.16857 të dt.31.07.2010 në emër të te demtuareve Bajram Avdijaj e Nuredin Xhemajli, reporti i ekspertizës mjeko-ligjore i Dr. Arbenit Seli të datës 14.12.2010 përkitazi me natyren dhe shkallen e lendimeve trupore te te demtuareve Bajram Avdijaj e Nuredin Xhemajli, i cili i pershkruan lemdimet të marra në sulmin fizik të datës 31.07.2010 dhe atë: mbretje e trupit, regjionit te kafazit te krahorit, regjionit te kafkes se kembes se majtë ne forme te ndrydhjeve te percjella me gervishtje siperfaqesore te formes lineare per te dy te demtuarit e lartecetur, te cilat lendime kane karakter të lëndimeve të lehta trupore me pasoja eventuale të mëvonshme për jetë dhe punë, të cilat lëndime në momentin e shkaktimit kanë qenë te shkaktuara nga dinamika e mjetit te forte si dora, grushti, komba etj, si dhe fotodokumentacioni ne vendin e ngjarjes.

Gjykata ne cilesin e te demtuareve i degjoi si deshmitar zyrtaret policor Bajram Avdijaj dhe Nuredin Gjemajli si dhe deshmitaret zyrtaret policor te Alpes ne Prizren Mehmet Morina e Bajram Berisha, qe ishin ne detyre zyrtare ne rastin konkret.

Nga fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, shihet vendi se ku ka ndodhë ngjarja dhe ate veturat e aksidentuara, vetura zyrtare e policise, si dhe konstatimi i i alkotestit te i akuzuari i cili ishte nen ndikim te alkoolit prej 1,42 promila.

93

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarve Said Regj. dhe të njëjtës pjesërisht ja fali besimin, pasi që i njëjti edhe pse gjatë shqyrtimit kryesorë nuk e ka pranuar vepren penale si nen 1 te dispozitivit te akuzes, dhe është deklaruar i pafajshëm ai në tërësi e ka pranuar fajesin sa i perket vepres penale nen 2 te dispozitivit te kesaj akuze dhe se ka pranur se diten kritike ka pasur një aksident trafiku me një viture tjeter dhe se ka pasur edhe një mosmareveshje me policet e trafikut ku i njëjti ne fillim thote se ka qene i provokuar dhe i ofenduar banalish nga polici Bajrak Avdić, me fjalet pijandur e kelysh, kurse me pas edhe ky duke ia kthyer ka pranuar se i ka ofenduar banalish policin te demtuarin Bajrak Avdić, gjithashtu i njëjti edhe pse në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nuk e ka goditur fizikisht me shkel policin Bajrak, ndërsa gjykata kesaj deklarate të te akuzuarit nuk ia fali besimin pasi që e njejta ka per qellim qe te shmanget nga përgjegjësia penale.

Nga arsyerat e lartpërmendura e bazuar në të gjitha deklaratat dhe provat materiale të administruara në shqyrtimin kryesorë vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit Said Regj. formohen të gjitha elementet qensore të veprës penale pengim i personave zyrtar gjate kryerjes se detyres zyrtare nga neni 316 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se, andaj edhe shqiptoj denimin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më parë duke vërtetuar në tërësi përgjegjësispëri e tij penalo juridike pasiqë nuk është gjetur as një rrethane e cila do të përashtonte përgjegjësinë eventuale të të akuzuarit, andaj gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor për vepren penale si ne dispozitivin nen 1 te kesaj akuze, dhe i shqiptoj sankcionin penal, e qe më parë duke vërtetuar në tërësi përgjegjësispëri e tij penalo juridike .

Me rastin e marjes së vendimit mbi dënimin gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitës së nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënit. Gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht rrënduese sa i përket të akuzuarit Said Regj., ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se i njëjti eshte i pa pune, se pas kryerjes se vepres penale ka pasur qëndrim dhe sjellje tejet korekte, se gjëri më tanë nuk kanë qenë i gjykuar dhe nuk kanë ra në kundërshtim me normat pozitive të shoqërisë, i penduar per kete vepër penale, dhe premton se ne te ardhmen nuk do te perserise edhe njehet keso lloj te veprave penale, kështu që denimi i shqiptuar si në shqiptim të aktgjykimit është në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale juridike të akuzuarit kështuqë sipas bindjes së gjykatës me këtë denim do të arihet qëllimi i denimit të paraparë si ne dispozitat të KP-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 453 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJKYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1627/2014 datë 15.07.2016

Sekretare Juridike
Fatme Bajraktari

Gjkatesi
Fatmir Krasniqi